



UEFA
EURO2024
GERMANY



SHQIPËRI - ÇEKI

AIR ALBANIA STADIUM

E ENJTE | 12 TETOR | ORA 20:45



AIR ALBANIA STADIUM

E MARTË | 17 TETOR | ORA 18:00

SHQIPËRI BULLGARI



**WHEN
EVERYTHING
IS IN YOUR
HANDS**

**BECOME
YOUR OWN
HERO.**

Të dashur miq të futbollit,
Duket sikur nuk ka kaluar asnjë ditë që pas asaj fitoreje 2-0 në 'Air Albania' kundër Polonisë. Atmosfera është thuajse e njëjtë, të gjithë të lumtur dhe pranë kualifikimit në Kampionatin European 'Gjermani 2024'. Është një ëndërr që shpesh duket shumë e afërt, por njëkohësisht edhe shumë e largët. Ende nuk ka mbaruar asgjë. Tre ndeshjet e mbetura, e kryesisht kjo sonte ndaj Çekisë, janë shumë të rëndësishme. Nuk është ndeshja e jetës për Shqipërinë, por për t'u kualifikuar duhet të bëjmë mirë në këtë sfidë si edhe në dy sfidat e tjera ndaj Moldavisë e Ishujve Faroe.

Kemi hedhur hapa shumë të rëndësishëm përpara. Ëndrra 'Gjermani 2024' nuk është më një utopi. Është diçka që mund ta arrijmë. Kemi një grup djemsh fantastik, nga porta në mbrojtje, mesfushë e sulm. Futbollistë që jo vetëm luajnë në klubet e tyre, por janë elementë kyçë e titullarë në çdo ndeshje me ekipet e tyre. Trajneri Silvinjo ka krijuar dy skuadra, 11-shen që hedh në fushë dhe skuadra tjetër pret nga momenti në moment në pankinë për të dhënë kontribut për Shqipërinë. Të zëvendësosh një yll, me një tjetër yll. Çfarë ditësh për Shqipërinë tonë!

Ndeshja e sotme duhet marrë shumë seriozisht. Çekia ka një ekip të fortë, janë fizikë, kanë pësuar vetëm dy gola dhe nuk kanë humbur asnjë ndeshje. Dhe një prej golave ua shënoi pikërisht 10-shi ynë, Nedim Bajrami. Duhet shumë energji për të përballuar këtë ndeshje. Djemtë tanë e kanë.

Kam besim se ashtu sikurse në ndeshjet e kaluara, ata do të lënë shpirtin e zemrën në fushë dhe të prodhojnë një rezultat pozitiv që do të ka kënaqte të gjithëve.

Mungesa e gjigandit tonë të mbrojtjes, Ardian Ismajli, nuk është aspak një lajm i mirë për ne. Por një trajner i zoti si Silvinjo do të dijë t'i japë zgjidhje kësaj dileme dhe të na qetësojë të gjithëve. Kemi besuar që në fillim tek ai dhe na ka bindur me çdo zgjedhje të tijën. Rikthimi i Armando Brojes është një lajm shumë pozitiv nga ana tjetër. Tashmë me të, plotësohet e gjithë vija e sulmit kuqezi. Uroj që edhe rikthimi i tij në skuadër të shoqërohet me një gol 'alla Broja'.

Sfidë e vështirë, e rëndësishme, por jo e pamundur për të nxjerrë një rezultat pozitiv. 11 janë çekët, 11 jemi edhe ne në fushë. Por rreth e përqark fushës kemi mbi 21 mijë tifozë shqiptarë, të cilët kanë ardhur nga e gjithë bota për të mbështetur Kombëtaren tonë drejt kualifikimit në finallet e Kampionatit të ardhshëm European 'Gjermani 2024'. Një këshillë dhe për ta: Të kenë kujdes me hedhjen e sendeve si edhe mjeteve piroteknike. Dëmtojnë veten dhe Kombëtaren tonë.

I uroj shumë suksese sonte kuqezinjtë tanë. Dhe jo vetëm sonte, por edhe në miqësoren e 17 tetorit me Bullgarinë. Për ta nuk është vetëm një miqësore. Është kundërshtari i radhës nga të cilët duan të marrin një rezultat pozitiv. Dhe unë besoj te ta. E gjithë Shqiptaria beson te kjo Kombëtare, që si kurrë më parë duhet pagëzuar si Kombëtarja jonë e yjeve.

Miqësisht,
Armand Duka

Porosite online në:
www.shop.amacaffe.com

ama
CAPSULE

ama
CAPSULE

TREND

SOPRANO

ama
CAPSULE

Compatible to Nespresso® machine

S

Sylvio Mendes Campos Junior, pasi e ka bërë "vijë" krahun në fushën e blertë, po tenton të lërë shenjë si trajner. Ai nuk u është trembur ndonjëherë sfidave, as kur u bë braziliani i parë që veshi fanellën e Arsenalit në vitin 1999, as kur pranoi të drejtonte Shqipërinë me synimin për ta çuar në Kampionatin Europian "Gjermani 2024". Si futbollist, Sylvinho, ka provuar të fitojë, që kur ishte pjesë e Corinthians. Kampion në Brazil, më pas tre herë kampion edhe në Spanjë me Barcelonën. 49-vjeçari ka fituar me katalanasit edhe dy herë trofeun më të rëndësishëm për klube, UEFA Champions League. Një karrierë e pasur mes kampionësh si futbollist.

Sylvinho është munduar t'i bëjë hapat e vegjël, duke ia nisur si ndihmëstrajner i Cruzeiro në vitin 2011, pak muaj pasi kishte lënë futbollin e luajtur. Stacionet e radhës ishin Sport Recife dhe Nautico, para se të rikthehej te Corinthians si ndihmës i Tite. Në dhjetor të vitit 2014, trajneri aktual i Shqipërisë pranoi ftesën e Roberto Mancin-it për të qenë pjesë e stafit të tij tek Interi. Në korrik të vitit 2016 Silvinjo iu bashkua Brazilit, sërish krah Tite. Rreth tre vite te "Seleção" dhe më

pas momenti për të provuar eksperiencën e parë si "dirigjenti" kryesor në stafin teknik. Francezët e Lyon ia besuan stolin për disa muaj. Eksperiencë për Sylvinhon, që më pas u rikthye sërish në Brazil. Këtë herë për ta drejtuar Corinthians nga maji i vitit 2021, deri në shkurt të vitit pasardhës. Koha për pak pushim dhe më pas Shqipëria.

Epoka e re si shqiptonjë e Sylvinhos nisi me humbje, në Varshavë, por fryma që ka sjellë në Kombëtare ndihet. Pothuajse çdo ditë braziliani është në zyrë së bashku me ndihmësit e tij, Zabaleta e Dorivas, duke punuar për ndeshjen e radhës. Fluturime të shumta për të takuar futbollistët kuqezí dhe për t'u prezantuar projektin e tij. Besim i dhënë për ta dhe shpërblim i marrë me fitoret kundër Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Në këto 9 muaj ka edhe lojtarë të fituar, si Jasir Asani, ndërkohë që për herë të parë me Kombëtaren janë bashkuar edhe Mirlind Daku dhe Arbnor Muja.

Sylvinho e di shumë mirë që duhet eksperiencë dhe talent për të ecur përpara, si dhe motivimi i duhur. Ai po përpiqet t'ia japë këtë Shqipërisë, që të vazhdojë të ëndërrojë kualifikimin për të dytë herë në një Kampionat Europian. E do për vete, e do për tifozët shqiptarë që nuk e kanë zhgënjyer, duke e mbështetur në Poloni, në "Air Albania" ndaj Moldavisë dhe në Ishujt Faroe. Ata nuk munguan as në Pragë, kurse sot ndaj Polonisë e mbushën sërish folenë kuqezí. Koha për betejën e radhës...



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

**SYLVIO
MENDES
CAMPOS
JUNIOR**



MES ËNDRRËS SË MADHE DHE EUROGOLAVE

“KRYQËZIMET” E SHQIPËRISË DREJT GJERMANISË

Kanë mbetur edhe tre “kryqëzime”. Shqipëria, e drejtuar nga Sylvio Mendes Campos Junior, po ëndërron sërish kualifikimin në një European. Mundësitë janë reale, por askush nuk po fluturon. Të gjithë e dinë se duhet djersitur në fushë për të siguruar një biletë për në Gjermani. “Tre finale” është refreni i dëgjuar më shpesh këtë periudhë dhe e para është sonte, më 12 tetor, ndaj Çekisë. Në një stadium të mbushur plot duhet treguar maturi

për të marrë rezultat pozitiv. Pavarësisht gjithçkaje, mbetemi Shqipëria dhe gjithmonë duhet të luftojmë. E kemi bërë gjithë sezonin në kualifikueset e “Euro 2024” dhe nuk ka arsye të mos vazhdojmë ta bëjmë deri në fund. Misioni i parë, të kalojmë me sukses Çekinë, më pas fokusi te Moldavia dhe Ishujt Faroe. Sonte jemi 22 mijë zemra në fushë dhe stadium, ndërsa miliona të tjera rrahin fort në pritje të nisjes së takimit në “Air Albania”.

NISJA E RRUGËTIMIT

Gjithçka nisi në Poloni, me një humbje minimale. E para ndeshje me trajnerin Sylvinho në stol. Asnjë miqësore, direkt në një duel zyrtar dhe ndaj ekipit që shikohej si favoriti kryesor në grup. Shqipëria dha sinjale pozitive. Në Varshavë mund të kishte shënuar dhe ndoshta edhe ta merrte një pikë, por nuk ndodhi. Gjithsesi askush nuk e humbi besimin.

Kalendari i rezervonte kuqezinjtë dy “detyra shtëpie” më pas. E para Moldavia, në një “Air Albania” të mbushur plot. Aty nisi edhe cikli i rezultateve pozitive dhe i eurogolave. Jasir Asani, një aftrim i trajnerit Sylvinho, realizoi perlën e parë nga distanca. Askush nuk e priste, por ndodhi. Shqipëria triumfoi 2-0 dhe në listën e shënuesve e shënoi emrin edhe Nedim Bajrami. Për të dy ishte hera e parë që tundnin rrjetën me fanellën e Kombëtares. Tre pikët e para, detyrim. Beteja tjetër në Ishujt Faroe. Edhe atje misioni u krye me sukses. Shqipëria fitoi me rezultatin 3-1 dhe Bajrami ishte ai që e zhbllokoi rezultatin, duke konfirmuar formën e mirë. Vendasit barazuan në fundin e pjesës së parë, ndërsa 45 minutat e dyta nisën me eurogolin e radhës. Kristjan Asllani mendoj ta shënonte të parin gol me Shqipërinë në një mënyrë që të mos e harronte asnjëherë. Për ta mbyllur mbrëmjen në mënyrën e duhur mendoi Ernest Muçi, i cili shënoi edhe golin e tretë. Dy fitore në pak ditë dhe Shqipëria e shihte veten sërish në garë, pasi Polonia kishte humbur 2 nga 3 ndeshjet e luajtura.

KRYQËZIMET E FORTA

Shtatori ishte vendimtar për Shqipërinë. Duhej

3 GOLA

ka shënuar mesfushori i Kombëtares, Nedim Bajrami, duke qenë deri tani shënuesi më i mirë për kuqezinjtë në kualifikueset e “Euro 2024”



REZULTATET E SHQIPËRISË NË KUALIFIKUESET E “GJERMANI 2024”



27 MARS 2023			
POLONI	1 - 0	SHQIPËRI	
17 QERSHOR 2023			
SHQIPËRI	2 - 0	MOLDAVI	
20 QERSHOR 2023			
ISHUJT FAROE	1 - 3	SHQIPËRI	
7 SHTATOR 2023			
ÇEKI	1 - 1	SHQIPËRI	
10 SHTATOR 2023			
SHQIPËRI	2 - 0	POLONI	

KLASIFIKIMI, GRUPI E

Shqipëria	10 pikë
Çekia	8 pikë
Moldavia	8 pikë
Polonia	6 pikë
Ishujt Faroe	1 pikë




karakter dhe djemtë kuqezi e treguan. Beteja e parë luhej në Pragë, ndaj Çekisë. Baraz-uam 1-1. Edhe pse pësua më parë, disavantazhi zgjati vetëm 10 minuta. Nedim Bajrami shtoi emrin tek ata që kishin realizuar perla gjatë kualifikuesve të “Euro 2024”. Një gol që vlejti një pikë dhe që i dha edhe më shumë shpresë e besim Shqipërisë së Sylvinhos. Me moralin lart kuqezinjtë u kthyen në Tiranë, aty ku i priste sërish “Air Albania” i mbushur. Në një atmosferë fantastike duhej një mrekulli në fushën e lojës ndaj Polonisë dhe atë e realizoi Jasir Asani. Një gol që i ndryshoi rrjedhën gjithë takimit. Duhej edhe një tjetër për ta siguruar fitoren dhe Mirind Daku, lotët që derdhi pas ndeshjes në Pragë me Çekinë i ktheu në gëzim për të gjithë shqiptarët. Sulmuesi shënoi sapo u aktivizua dhe të gjithë ishin në delir. 70 vite kishte pritur Shqipëria të fitonte një ndeshje ndaj Polonisë dhe ia doli me rezultatin 2-0. Ndaj Çekisë kemi 71 vite fituar, por kurrë mos thuaj kurrë. Atëherë luhej në “Qemal Stafa”, tani në një “Air Albania” modern, me një ekip si Shqipëria që ka ndryshuar fytyrë dhe synon të shkojë për të dytën herë në një European. Të gjithë besojnë, le ta tentojmë deri në fund!



#gjithmonëmeKombëtare



STAFI TEKNIK I KOMBËTARES A



SHQIPËRIA



THOMAS STRAKOSHA



BERAT GJIMSHITI



FREDERIC VESELI



YLBER RAMADANI



JASIR ASANI



MYRTO UZUNI




ETRIT BERISHA




ENEA MIHAJ



NEDIM BAJRAMI



ARBNOR MUJA



SOKOL CIKALLESHI



MARIO MITAJ



KEIDI BARE



KRISTJAN ASLLANI



ERNEST MUÇI



MIRLIND DAKU



ELHAN KASTRATI



ARLIND AJETI



KLAUS GJASULA



ARMANDO BROJA



TAULANT SEFERI



ELSEID HYSAJ



QAZIM LAÇI



IVAN BALLIU

Mbrojtja më e mirë për makinën tuaj.

Siguroni automjetin tuaj me Kasko, i cili përballet me rreziqe sa herë që lëvizni në rrugë apo qëndroni në parking.

Sigurimi KASKO i makinës vetëm tek SIGAL UNIQA



Your journey continues through INFINITY

OUR SERVICES



Infinity Destinations (DMC) is a professional services organization that specializes in planning, organizing and managing various aspects of travel and events in a given destination.



We have detailed knowledge of the local area, including attractions, accommodations, transportation options, cultural nuances and logistical considerations.



We work closely with our clients to understand their goals, preferences and budget constraints, and then use our local knowledge and connections to design and deliver personalized experiences.

OUR HISTORY

Infinity Destinations was founded in 2013, offering exceptional customer service and customized travel packages. Over the years, the agency expanded its offerings to include adventure tourism, luxury cruises and cultural tourism.

OUR VISION


To be a leading service provider in travel management solutions- an entrepreneurial, innovative and inspiring company of choice for employees, customers, partners and shareholders.

OUR MISSION

We will demonstrate a return of investment to our customers and suppliers. We will empower our teams to make the best decisions for our customers. Our shareholders will be at the forefront of our business growth strategy.

CONTACT US





VAS
GROUP
Global Travel Company

Global Travel Company



VAS GROUP is a business group, which under its umbrella are a group of companies operating in the travel and tourism sector. Each company is a standalone brand by itself, depending on the type of services they provide in their respective markets. For years, VAS GROUP has been inspiring

the travel & tourism community by offering the most exclusive destinations at client's reach. The group is always engaged in innovating travel experiences and tailoring new services to widen the options for the business partners of each of its companies operating under VAS GROUP's name.

ALBANIA AUSTRIA BOSNIA&HERZEGOVINA TURKEY KOSOVA UAE SLOVENIA

albtours d
DMC IN BALKAN

QAS
tour operator

vasdream

VAS EVENT

PREMIUM GROUP HOTELS

PREMIUM

✉ contact@vasgroup.net

🌐 www.vasgroup.net




ZYRTARËT E NDESHJES SHQIPËRI - ÇEKI

ROLI	EMËR / MBIEMËR	KOMBËSIA
Arbitër	Danny Makkelie	Hollandë
Asistent i parë	Hessel Steegstra	Hollandë
Asistent i dytë	Jan de Vries	Hollandë
Arbitër i katërt	Alex Bos	Hollandë
VAR	Rob Dieperink	Hollandë
Asistent VAR	Jeroen Manschor	Hollandë
Vëzhgues i UEFA-s	Lucilio Batista	Portugali
Delegat i UEFA-s	Balázs Makray	Hungari

MAK ALBANIA HOTEL

KASTRATI
GROUP



#EQUAL GAME



**Everything you need,
plus the style and extras
you love!**

@makalbaniahotel

- 355 4227 4707 - 355 69 603 2575

reservations.tirana@makalbania.com

KUNDËR ÇEKISË PËRBALLJA E JETËS!

» NGATRITANKOKONA

Ajo që do të zhvillohet sot në Tiranë është përballja e tetë mes dy përfaqësueseve tona. Më saktë dhe po t'i referohemi fakteve historike kjo në fakt, është ndeshja e tretë me ekipin kombëtar të Republikës Çeke. Pesë të tjerat janë zhvilluar kundër përfaqësueseve të Çekosllovakisë. Më 1 janar 1993, Çekosllovakia u shpërbë në mënyrë paqësore, gjë që çoi në krijimin e dy shteteve të pavarura të Republikës Çeke dhe Republikës Sllovaqe.

Ballafaqimi i parë është zhvilluar në miqësoren e zhvilluar në vitin e largët 1950, pikërisht në 17 shtator në stadiumin "Armata Çekosllovaqe Strahov". Ishte një humbje e thellë, në prani të 35 mijë spektatorëve. Tre gola të shënuar nga vendasit nuk i lanë asnjë mundësi për të reaguar skuadrës kombëtare, që drejtohej nga Ludovik Jakova, që largohet kokëulur nga Praga. Dy vjet më vonë, Shqipëria hedh dorezën e sfidantit dhe e pret kundërshtarin në dy miqësore në Tiranë. Madje jo me një por me dy ndeshje miqësore. E para u zhvillua më 29 nëntor dhe Shqipëria pasi siguron avantazhin e dyfishitë në pjesën e parë mes golave të Gjinalit dhe Telitit. Në pjesën e dytë, dorëzohet përkohësisht pas dy golave të Çekosllovakëve. Në mënyrë dramatike, një minutë përpara përfundimit Jareci ka shënuar golin e avantazhit duke i sjellë fitoren skuadrës kuqezi.

...ajo që ka ndodhur në historinë e ballafaqimeve futbollistike mes kombëtareve shqiptare dhe Çeke. Por kjo e sotmja, është krejtësisht e vecaantë, për vetë pozicionet e të dyja skuadrave dhe ambiciet e tyre. Dhe ndoshta, ka për të qenë më e paharruara...

ÇEKOSLLOVAKI - SHQIPËRI 3-0

17 SHTATOR 1950

PRAGË, ARMATA ÇEKOSLLOVAKE STRAHOV - 35000

Gjyqtar: Posa (Hungari) - Miqësore

Shënuesit: 88' Hlavacek, 73' Cejp, 4' J. Zdarsky, Pesek

Shqipëria: - Vogli, Dibra, B. Boriçi, Spahiu, Shaqiri, Llambi, Parapani, Gjinali, Boriçi, Spahiu, Jareci, Bakalli. Tr. B. Jakova

Çekosllovakia: Morávek, Venglár, Trnka, Krásnohorský, Malatinský, František Vlček, Hlaváček, Preis, Tomáš, Cejp, Žďárský, Pešek

SHQIPËRI - ÇEKOSLLOVAKI 3-2 (2-0)

29 NËNTOR 1952

TIRANË, STADIUMI KOMBËTAR QEMAL STAFI

Gjyqtar: Mitran (Rumani) - Miqësore

Shënues: 2' Gjinali, 43' Teliti, 62' Myler, 76' Kvpil, 89' Jareci

Shqipëria: - Vogli, Dibra, Fagu, Spahiu, (F. Vogli), Shaqiri, Vila, Teliti, Gjinali, Boriçi, Jareci, Resmja. Tr. M. Alla

Çekosllovakia: Hanaček, Rubas, Ira, Kresel, Cermak (Dvorzhak), Kolaus, Myler, Novak, Vileta, Zhgjarski, Krapil

SHQIPËRI - ÇEKOSLLOVAKI 2-1 (2-1)

7 DHJETOR 1952

TIRANË, STADIUMI KOMBËTAR QEMAL STAFI

Gjyqtar: Mitran (Rumani) - Miqësore

Shënuesit: 5' Gjinali, 17' Boriçi, 32' Dvorzhak

Shqipëria: - Vogli, Dibra, Pelingu, Spahiu, Vila, Shaqiri (Peqini), Teliti (Parapani), Gjinali, Boriçi, Jareci, Resmja. Tr. M. Alla

Çekosllovakia: Hanaček, Rubas, Ira, Kresel, Cermak (Dvorzhak), Kolaus, Myler, Novak, Vileta, Zhgjarski, Kvpil

SHQIPËRI - ÇEKOSLLOVAKI 0-2 (0-0)

1 MAJ 1991

TIRANË - "Q. STAFI" - 7000

Gjyqtar: Longi (Itali) - Kampionati Evropian

Shënues: 47' Kubik, 66' Kuka

Shqipëria: - Nallbani, Zmijani, Dema, Daja, Ocelli, Shpuza, Kushta, Memushi, Barbullushi (Dosti), Dume (Kola), Milori. Tr. B. Birçe

Çekosllovakia: Mikloshlo, Kula, Kadles, Hashek (Hapal), Grusman, Titell, Njemec, Kubik, Kuka, Kokleta, (Hilek), Moravčík

ÇEKOSLLOVAKI - SHQIPËRI 2-1 (2-0)

16 TETOR 1991

OLIMPIE - "SIGMA" - 3500

Gjyqtar: Liskjević (Poloni)

Shënues: 35' Kula, 39' Lenez, 62' Zmijani

Çekosllovakia: - Miklosko, Hapal, Jurashka, Kula, Titell, Nemeček, Lariz, (Sedhaček), Kuka, Daneek, (Pečka), Frydek, Moravčík

Shqipëria: - Strakosha, Zmijani, Cipi, A. Kola, (Daja), Lekbello, Kaçaj, Joca, Milori, Gjondeda, Abazi, Barbullushi. Tr. B. Birçe

ÇEKI-SHQIPËRI 3-1

QERSHOR 2021

PRAGË, GENERALI ARENA

Gjyqtar: Peter Kralović, Trnava / Slovacia

Shënues: 1-0 (18') Patrik Schick, 1-1 (42') Sokol Cikalleshi, 2-1 (68')

Lukáš Masopust, 3-1 (89') Ondřej Čelůstka

Çekia: Vaclík, Čelůstka, Bořil, Coufal, Kalas, Darida, Barák, Masopust, Pešek, Souček, Jankto, Hložek, Schick, Pekhart, Král, Holeš

Shqipëria: Selmani, Veseli, Doka, Gjimsiti, Trash, Lenjani, Kumbulla, Ismajli, Abrashi, Laçi, Bare, Kallaku, Çekiçi, Cikalleshi, Seferi, Manaj, Balaj

ÇEKI-SHQIPËRI 1-1

7 SHTATOR 2023

EDEN ARENA, PRAGË

Gjyqtar: Anthony Taylor

Shënues: Václav Cerný '56, Nedom Bajrami '66

Çekia: Jiří Pavlenka, Jakub Brabec, Vladimír Coufal, Tomáš Holeš, Ladislav Krejčí, Alex Král, Lukáš Provod, Tomáš Souček, Václav Cerný, Tomáš Cvančara, Jan Kuchta

Shqipëria: Etrit Berisha, Berat Djimsiti, Ardian Ismajli, Elseid Hysaj, Mario Mitaj, Kristjan Asllani, Nedom Bajrami, Sokol Cikalleshi, Ylber Ramadani, Tauliant Seferi, Jasir Asani

Pas tetë ditësh më 7 dhjetor të dyja skuadrat zbresin për të përplasur "brirët" në miqësoren e dytë. Gjinali dhe Boriçi siglojnë dy gola të shpejtë. Përpjekja e Çekosllovakëve nuk shkon më shumë se shkurtimi i distancës së golave dhe Shqipëria arrin fitoren e dytë. Trajneri Myslym Alla, që drejtoi skuadrën në këto dy sfida, është i vetmi deri më tani që ka arritur ta mundë dy herë përfaqësuesen Çekosllovakë.

Ballafaqimi i parë zyrtar i Shqipërisë me Çekosllovakinë erdhi në vitin 1991. Kombëtarja e drejtuar nga Bejkush Birçe nisi të përballej me vështirësi të mëdha. Kishte filluar epoka e tranzicionit dhe ekipi kombëtar u përball menjëherë me eksodin e futbollistëve, vështirësitë e panumërta financiare dhe mungesën totale të vëmendjes së institucioneve. Për rrjedhojë, regjistrojmë dy humbje. Më 1 maj humbim 0-2 në Tiranë dhe më 16 tetor, 2-1 në Çekosllovakia në ndeshjen e dytë, ku pas dizavantazhit 2-0 arritëm të shkurtim distancën e golave me anë të Zmijanit.


Duhet të kalonin afro 20 vjet që Shqipëria të përballej me Republikën Çeke, këtë herë në një miqësore të zhvilluar në Pragë ekipi i drejtuar nga Edi Reja u mund 3-1 nga vendasit. Golin e vetëm në këtë ndeshje për Shqipërinë e shënoi Sokol Cikalleshi. Përballja e fundit, njëkohësisht e para me emërtimin Republika Çeke, është ndeshja e 7 shtatorit në Pragë. Ndoshta edhe më e bukura dhe më e luftuara në historinë e ndeshjeve kundër tyre. Kombëtarja e drejtuar nga Silvinjo arriti të barazojë avantazhin e vendasve me anë të Nedim Bajramit duke hedhur një hap serioz drejt kualifikimit për në finalen e Europianit "Gjermani 2024".

Kjo ishte pak a shumë, ajo që ka ndodhur në historinë e ballafaqimeve futbollistike mes kombëtareve shqiptare dhe Çeke. Por kjo e sotmja, është krejtësisht e vecaantë, për vetë pozicionet e të dyja skuadrave dhe ambiciet e tyre. Dhe ndoshta, ka për të qenë më e paharruara...

BULLGARIA



IVAYLO
CHOCHEV



KIRIL
DESPODOV



MARTIN
MINCHEV



PRESLAV
BORUKOV




KRISTIAN
DIMITROV



ANDRIAN
KRAEV



MARIN
PETKOV



IVAN
TURITSOV



IVAN
YORDANOV



ILJAN
ILIEV



ILIA
GRUEV



YOAN
STOYANOV



LUKAS
PETKOV



DIMO
KRASTEV



DOMINIC
YANKOV



VIKTOR
POPOV



VALENTIN
ANTOV



SIMEON
PETROV



SPAS
DELEV



GEORGI
RUSEV



PATRIK GABRIEL
GALCHEV



DANIEL
NAUMOV



DIMITAR
MITOV



IVAN
DYULGEROV



ALEX
PETKOV

E krijuar për aventurë.

E lindur në natyrë.





TË GJITHA PËRBALLJET ME SHQIPËRISË DHE BULLGARISË:			
DATA	NDESHJA	REZULTATI	KOMPETICIONI
09.10.1946	SHQIPËRI – BULLGARI	3-1	Kupa Ballkanike
15.07.1946	BULLGARI – SHQIPËRI	2-0	Kupa Ballkanike
17.11.1949	BULLGARI – SHQIPËRI	0-0	Miqësore
04.06.1950	SHQIPËRI – BULLGARI	2-1	Miqësore
19.10.1980	BULLGARI – SHQIPËRI	2-1	FIFA World Cup
14.10.1981	SHQIPËRI – BULLGARI	0-2	FIFA World Cup
06.09.1995	SHQIPËRI – BULLGARI	1-1	UEFA European Championship
07.10.1995	BULLGARI – SHQIPËRI	3-0	UEFA European Championship
30.04.2003	BULLGARI – SHQIPËRI	2-0	Miqësore
28.03.2007	BULLGARI – SHQIPËRI	0-0	UEFA European Championship
17.10.2007	SHQIPËRI – BULLGARI	1-1	UEFA European Championship

Përballja me Çekinë të enjten e 12 tetorit është një nga sfidat më të rëndësishme për kuqezinjtë e Silvinjos. Megjithatë, pas këtij takimi, Shqipëria duhet të lërë pas krahëve çdo rezultat të marrë ndaj çekëve dhe duhet të përqëndrohet totalisht në ndeshjen e radhës. Edhe pse në letër ndeshja ndaj Bullgarisë është vetëm një miqësore, për trajnerin Silvinjo dhe skuadrën shqiptare nuk konsiderohet si e tillë. Grupi i bashkuar, shpirti i skuadrës, dëshira për të fituar, kënaqësia e marrë nga një ndeshje – janë të gjitha aty. Dhe Shqipëria duhet ta shfrytëzojë më së miri këtë ndeshje.

Bullgaria nuk është një kundërshtar fort i lehtë. Pavarësisht se ka thuar se 11 muaj që nuk ka regjistruar një rezultat pozitiv, që prej 16 nëntorit të vitit të kaluar. E fundit është ajo ndaj Qipros, ku bullgarët fituan 2-0. Dhe kjo është pikërisht ajo që kërkohet nga Shqipëria, të shfrytëzojë këtë moment. Nga njëra anë, momentin e mirë që po kalojnë vetë kuqezinjtë dhe nga ana tjetër 'problemet' e Bullgarisë.

Me Bullgarinë jemi përballur plot 11 herë, të martën e 17 tetorit regjistrojmë

ndeshjen e dymbëdhjetë. Në takimin e parë mes dy përfaqësuesve, që daton më 9 tetor 1946 dhe ishte i vlefshëm për Kupën Ballkanike, kuqezinjtë e drejtuar nga trajneri serb Ljubisha Brocic fituan me shifrat 3-1. Shkëlqeu me paraqitjen e tij kapiteni Loro Boriçi, i cili realizoi dy gola, ndërsa shënoi edhe Pal Mirashi. Sakaq, hera e fundit që Shqipëria fitonte ndaj Bullgarisë është në vitin e largët 1950, me rezultatin 2-1. Shënonte sërish legjenda e futbollit shqiptar Loro Boriçi dhe Vasif Biçaku. Që prej atij viti, Shqipëria dhe Bullgaria u përballën edhe 7 herë të tjera. Dhe bilanci është 5 humbje për Shqipërinë dhe vetëm 2 barazime.

Fiks 16 vite më pas, 17 tetor 2007 – 17 tetor 2023, Shqipëria dhe Bullgaria do të zbresin sërish në fushë për duelin e radhës. Hera e fundit ishte në 'Qemal Stafa' dhe kuqezinjtë nuk shkuan më shumë se barazimi 1-1. Tashmë 'Qemal Stafa' ose ndryshe 'Air Albania' do të presë miqësoren e radhës të Shqipërisë. Nuk vlen vetëm rezultati pozitiv në këtë ndeshje, por vlen grupi, lojtarët, stafi, tifozët. Një miqësore që duhet shfrytëzuar në çdo detaj.



SHQIPËRI - BULLGARI NUK ËSHTË THJESHT DHE VETËM NJË MIQËSORE





Vodafone
GIGATV



Një spektakël i madh sportiv

Merr **DigitAlb Premium** ose **Tring Sport**
në çdo dyqan Vodafone dhe shijo
emocionet e ndeshjeve të **Serie A**.

Together we can

